

Patentë shoferësh të shteteve tjera

Patentë shoferësh të vendeve tjera vlejné në disa raste edhe në Suedi. Këtu mund të lexoni mbi rregullat që vlejné, varësisht nga ajo se në cilin vend është lëshuar patenta e shoferit.

Patentë shoferi nga shtetet EES dhe vlefshmëria e tyre në Suedi

Patentë shoferësh që janë lëshuar në ndonjë nga shtetet e këshillit për bashkëpunim ekonomik europian, EES, vlejné edhe në Suedi, nëse më parë plotësohen disa kushte.

Shtetet EES janë: Austria, Belgjika, Britania e Madhe, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Irlanda, Islanda, Italia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Qipro, Rumania, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja.

Që një patentë shoferi nga ndonjë shtet EES të vlejë në Suedi kërkohet që:

- patentë shoferi të vlejë edhe në shtetin në të cilin është lëshuar,
- patentë shoferi të mos është ndërruar me patentë shoferi të Suedisë
- mbajtësi të mos ketë patentë shoferi suedeze që është konfiskuar apo shfuqizuar.

Nëse keni patentë shoferi të ndonjë shteti EES që përmbush këto kërkesa patenta do të vlejë edhe në Suedi, edhe nëse jeni të regjistruar në Suedi dhe pavarësisht asaj sa gjatë jeni i/e regjistruar. Ju mundeni poashtu të lejoheni të jeni instruktor privat në ushtrime drejtimi të automjetit, nëse për këtë ju i plotësoni kërkesat.

Ndërrimi i patentë shoferit nga shtetet EES

Patentë shoferi nga ndonjë shtet EES mund të ndërrohet me patentë ekuivalente suedeze nëse patenta vlen në Suedi dhe nëse mbajtësi ka qëndrim permanent në Suedi. Plotësoni formularin "Ansökan om utbyte av utländskt körkort" të cilën mund ta porositni në faqen "blanketter". Kjo faqe nuk është e përkthyer.

Veni re që shërbimi elektronik "Beställ blankett" funksionon vetëm nëse Transportstyrelsen posedon të dhëna mbi numrin tuaj personal apo koordinues si dhe adresën tuaj në Vägtrafikregistret.

Ju mund poashtu të kontaktoni Transportstyrelsen, repartin për çështje mbi patentë shoferësh, në telefonin 0771-81 81 81.

Patentë shoferësh nga shtete tjera – vlefshmëria e tyre në Suedi

Që patentë shoferi nga ndonjë vend tjetër të vlejë në Suedi kërkohet që:

- patentë shoferi të vlejë edhe në atë vend në të cilin është lëshuar,
- mbajtësi të mos jetë i regjistruar në Suedi më gjatë se një vit,
- patentë shoferi të mos jetë ndërruar me patentë shoferi të Suedisë
- mbajtësi të mos ketë patentë shoferi suedeze që është konfiskuar apo shfuqizuar.

Mbi formën e patentë shoferit ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare (konventat 1949 dhe 1968 mbi trafikun rrugor). Patentë shoferi forma e së cilës nuk përputhet me këto rregulla dhe që nuk është e lëshuar në gjuhën angleze, gjermane apo frënge, vlen vetëm së bashku me përkthim të vërtetuar në anglishte, gjermanishte, frëngjishte, suedishte, danishte apo norvegjishte. Patentë shoferi që nuk ka fotografi vlen vetëm së bashku me dokument identiteti të pajisur me fotografi.

Ndërrimi i patentë shoferit të shteteve jashtë EES

Patentë shoferi nga ndonjë shtet jashtë EES nuk mund të ndërrohet me patentë shoferi të Suedisë.

Nëse ju ndërkaq keni patentë shoferi që është lëshuar në Zvicër ose Japoni atëherë ju mund ta ndërroni atë me një patentë ekuivalente suedeze. Me kusht që patentë shoferi të vlejë në Suedi, që ju të plotësoni kërkesat personale dhe mjekësore për patentë shoferi që vlejë në Suedi dhe që ju të keni qëndrim permanent në Suedi.

Veni re – nëse dëshironi të ndërroni patentë shoferin që është lëshuar në Zvicërr apo Japoni me patentë suedeze ju këtë duhet ta bëni brenda një viti prej ditës së regjistrimit në Suedi.

Kërkesës për ndërrim të patentë shoferit që është lëshuar në Zvicërr apo Japoni duhet t'i bashkangjiti një deklaratë shëndetësore me një vërtetim mbi kontrollimin e syve apo vërtetim tjetër mjekësor nëse kërkesa vlen për kategoritë C, CE, D dhe DE. Formularë për vërtetim mund të porositni nëpërmjet shërbimit elektronik "Beställ blanket". Ky shërbim elektronik nuk është i përkthyer.

Të dhëna që vlejë për të gjitha patentë shoferësh të shteteve tjera

Kërkesa t'i dërgohet Transportstyrelsen, 701 97 Örebro.

Që kërkesa të shqyrtohet duhet të paguani një taksë, taksën e paguani me anë të fakturës që Transportstyrelsen ua dërgon.

Duhet që ju vetë të dëshmoni sa kohë keni patentë shoferin. Në Suedi nuk keni të drejtë të drejtoni automobil para se të keni mbushur 18 vjet, edhe nëse këtë të drejtë e gëzoni në atë vend nga keni ardhur.

Rregullat mbi konfiskim të patentë shoferit nga Policia apo të shfuqizimit të saj nga Transportstyrelsen vlejë edhe për patentë shoferi të lëshuara jashtë Suedisë. Pjesë të

rëndësishme të ligjit dhe rregullores mbi patentë shoferin vlejnë edhe për patentë shoferi të lëshuara në shtete tjera.

Përfundim

Sipas rregullores për patentë shoferi, Transportstyrelsen, duke iu referuar rrethanave speciale, mund të aprovojë përjashtime nëse me këtë nuk rrezikohet siguria në trafik.